

UDHËZIM
Nr.1956, datë 19.9.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA NR.1281, DATË 15.7.2004 “PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1766/1, DATË 17.9.2003 “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.277, DATË 18.6.1997 “PËR PËRFITIMIN NGA STATUSI I TË VERBËRIT”” (I NDRYSHUAR)”

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1766/1, datë 17.9.2003 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimin nga statusi i të verbërit” (i ndryshuar), bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 të udhëzimit, kudo ku përdoret shprehja “...6800 lekë në muaj...” zëvendësohet me shprehjen “...është 8000 lekë në muaj...”.

2. Në pikën 3 të udhëzimit, shprehja “...prej 13 600 lekë në muaj (2 x 6800 lekë)...”, zëvendësohet me shprehjen “...është 16 500 lekë në muaj...”.

3. Në pikën 4 dhe 5 të udhëzimit, shprehja “...përkatësisht 20 400 lekë në muaj (3x6800 lekë) zëvendësohet me shprehjen “përkatësisht 24 800 lekë në muaj...”.

4. Në pikën 6 të udhëzimit, shprehja “është 10 200 lekë në muaj (150% 6800)” zëvendësohet me shprehjen “12 000 lekë në muaj.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2006.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka**